

Pasqyrat Financiare

Montessori – Albania Shpk

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e performancës financiare	2
Pasqyra e lëvizjeve të kapitalit:	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime të pasqyrave financiare	5-20

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët e Montessori Albania sh.p.k

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të 'Montessori Albania sh.p.k' ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në seksion e raportit tonë *Baza për Opinionin me Rezervë*, pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin me rezervë

Pasqyra e e pozicionit financiar të Shoqërisë përmban llogari të arkëtueshme tregtare në vlerë neto 90,318,958 lekë (2018 – 87,534,703 lekë) të cilat përfshijnë shumën prej 32,331,592 lekë e cila përfaqëson teprica me vjetërsi më të madhe se dy vite me gjasa në dukje të ulëta rekuperimi. Megjithëse ekzistonin të dhëna objektive zhvlerësimi për këto llogari në atë datë, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit. Rrjedhimisht, ne nuk mund të përcaktojmë nëse kishte nevojë për rregullime për provizionimin e llogarive të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga entiteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë

Pasiguri materiale për parimin e vijmësisë

Ne terheqim vëmendjen në shënimin shpjegues 4 a) ku tregohet se Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare mbi bazën e parimit të vijmësisë. Shoqëria është ende në procesin e vlerësimit të impaktit të pandemisë COVID -19 si edhe është duke rishikuar buxhetin për periudhën e mbetur të vitit 2020. Në kushtet e vazhdimit të pandemisë dhe mungesës së buxhetit të përshtatur për përballimin e situatës ekziston një pasiguri materiale për parimin e vijmësisë. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare përputhje në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijmësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijmësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijmësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.


- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.


Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

30 korrik 2020





Fatjan Devija
Auditues Ligjor



Pasqyra e Pozicionit Financiar


	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	5	6,442,991	11,043,069
Llogari të arketueshme tregtare	6	90,318,958	87,534,703
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	16,132,032	16,876,269
		112,893,980	115,454,041
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	407,050,071	414,445,999
Aktive afatgjata jomateriale	9	1,949,158	2,598,877
		408,999,229	417,044,876
Total Aktive		521,893,209	532,498,917
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	83,575,132	76,403,193
Qira financiare afatshkurter	11	2,611,303	1,985,306
Llogari të pagueshme tregtare	12	103,537,259	88,179,282
Detyrime tatimore	13	5,508,490	6,057,574
Parapagime dhe të ardhurat e shtyra	14	199,777,294	209,680,361
Të tjera detyrime	15	11,774,444	10,245,067
		406,783,922	392,550,783
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	10	129,895,495	150,476,984
Qira financiare afatgjate	11	5,062,403	5,482,015
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	16	45,059,512	46,350,772
Grante dhe të ardhurat e shtyra	17	5,178,039	5,178,040
		185,195,450	207,487,811
Totali i Detyrimeve		591,979,371	600,038,594
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	18	100,000	100,000
Rezerva rivleresimi	19	1,740,288	2,252,077
Fitime të mbartura	20	(69,379,965)	(33,572,385)
Fitimi i ushtrimit	21	(2,546,486)	(36,319,369)
Total kapitali		(70,086,163)	(67,539,677)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		521,893,209	532,498,917

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe firmosur nga Administratori i Montessori Albania Shpk më 30 mars 2019:



Znj. Mirlinda Boshnjaku
Administrator

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet në tërësi së bashku me shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet nga 5 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



Pasqyra e Performancës Financiare

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	367,323,927	362,275,751
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	23	3,712,454	3,719,788
Shpenzime për veprimtarite e shfrytëzimit		(111,401,621)	(122,984,791)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	24	(8,377,510)	(9,861,444)
Shpenzime Administrative	25	(103,024,112)	(113,123,347)
Shpenzime te personelit	25	(221,646,447)	(222,893,427)
Paga dhe shperblime	26	(202,793,799)	(205,445,269)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetesore	26	(18,852,648)	(17,448,158)
Shpenzime amortizimi	27	(11,234,669)	(12,497,755)
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	28	(9,358,389)	(19,544,953)
Shpenzime financiare	29	(16,104,048)	(24,025,765)
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme		(16,104,048)	(24,025,765)
Fitimi/humbja para tatimit		1,291,208	(35,951,152)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	30	(3,837,693)	(368,217)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(3,837,693)	(368,217)
Humbja e vitit	30	(2,546,486)	(36,319,369)
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Diferencat (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale			
Te ardhurat te tjera gjithperفشیرهه per vitin			
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(2,546,486)	(36,319,369)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet nga 5 deri në 20 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Montessori Albania Shpk
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2019

Shumat janë të shprehura në Lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali themeltar	Rezerva Rivlerësimi	Fitime te Pashpërndara	Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2018	100,000	2,897,954	(31,083,748)	(3,134,516)	(31,220,308)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi/Humbja e vitit				(36,319,369)	(36,319,369)
Transferim ne lirimet e mbartura			(3,134,516)	3,134,516	-
Transferim i tepricës nga rivlerësimi		(645,877)	645,877	-	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2018	100,000	2,252,077	(33,572,385)	(36,319,369)	(67,539,677)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi/Humbja e vitit				(2,546,486)	(2,546,486)
Transferim ne fitime te mbartura			(36,319,369)	36,319,369	-
Transferim i tepricës nga rivlerësimi		(511,789)	511,789	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	1,740,288	(69,379,965)	(2,546,486)	(70,086,163)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënime shpjeguese të paraqitura në faqet nga 5 deri në 20 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Pasqyra e Flukseve Monetare

		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Humbja e vitit		(2,546,486)	(36,319,369)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	28	11,234,669	12,497,755
Rrije në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(2,588,393)	52,650,641
Rënie në detyrimet e pagueshme		6,435,203	36,142,439
Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit		12,534,993	64,971,466
Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	9,10	(3,931,907)	(8,489,402)
Mjete monetare neto i përdorur në aktivitetin e investimit		(3,931,907)	(8,489,402)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i financimit			
<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit themeltar</i>			
Hua të (paguara)/arkëtuara		(13,203,165)	(46,433,167)
Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit		(13,203,165)	(46,433,170)
Rënie neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(4,600,078)	10,048,898
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		11,043,069	994,171
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2019	5	6,442,991	11,043,069

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet nga 5 deri në 20 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shënimet Shpjeguese

1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Montessori -Albania Shpk është rregjistruar si një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Regjistrin e Shoqërive me datë 11.12.2007, në përputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Mbi Shoqëritë Tregtare” me NIPT K72411007G.

Veprimtaria e Shoqërisë është arsimi jo publik për ciklin parashkollor, 9-vjeçar dhe atë të mesëm, organizimi i kurseve të ndryshme etj.

Administrator i Shoqërisë Montessori-Albania Shpk që prej viti 2015 e në vazhdim është Znj. Mirlinda Boshnjaku.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga: Medar Shtylla, Selitë e Vogël, pranë Komleksit Dinamo, Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në dy ambiente. Për ciklin e ulët në kopësht në godinën “IMSA”, (International Montessori School of Albania) në adresën: Rruga: Medar Shtylla, Selitë e Vogel, pranë Komleksit Dinamo, Tiranë.

Për ciklin 9-vjeçar dhe atë të mesëm, aktiviteti kryhet në godinën “WAT” (World Academy of Tirana) me adresë: Rr.Rezervave, në krahë të Arkivës së Shtetit, Lundër, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria kishte 106 punonjës përfshirë Administratorin e saj. (2018: 106 punonjës)

2 Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të kontabilitetit (“SKK”).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, monedha shqiptare, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijueshmërisë, i cili supozon që Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj në të ardhmen e parashikueshme. Pasiguritë mbi parimin e vijueshmërisë trajtohen në shënimin 4.

3 Përmbledhje e politikave kontabël

3.1 Monedha e huaj

3.1.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë ato transaksion të cilat kryhen nga Shoqëria në monedhë të ndryshme nga monedha e saj funksionale. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në atë vendase sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj, konvertohen në Lekë sipas normës së këmbimit të fundit. Diferencat e lindura nga konvetimi paraqiten në pasqyrën e performancës. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhe të huaj, të deklaruar me kosto historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën e trasaksionit.

3.1.2 Operacionet e huaja

Rezultatet dhe pozicioni financiar i një dege, monedha funksionale e të cilit është e ndryshme nga ajo e prezantimit të shoqërise, konvertohet në lekë si me poshtë:

- Aktivitet dhe detyrimet konvertohen me kursin e këmbimit në datën e raportimit;
- Të ardhurat dhe shpenzimet konvertohen me kursin e këmbimit të përafërt me kursin e këmbimit që përkon me datën e transaksionit.

Diferencat e kursit të këmbimit të cilat janë pasojë e konvertimit në Lekë njihen me mënyrë të drejtpërdrejtë në rezervën e konvertimit që përfshihet në kapital. Kur nga një pjesëmarrje në monedhë të huaj është hequr dorë, pjesërisht ose në tërësi, vlera përkatëse në rezervën e konvertimit në monedhë të huaj transferohet në pasqyrën e performancës.

3.2 Instrumentat financiare

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo derivative, përfshirë llogari të arketueshme tregtare dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalente të saj, hua, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera. Gjithë aktivitet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht në datën e blerjes në të cilën Shoqëria bëhet palë e parashikimeve kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të tij. Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin prej aktivitet përfundojnë, ose ajo i transferon të drejtat për të marrë flukse monetare kontraktuale nga aktivi financiar nëpërmjet një transaksioni, ku në mënyrë thelbësore gjithë rreziqet dhe perfitimet e pronësisë së aktivitet financiar transferohen. Çdo interes mbi aktivitet financiare të transferuara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria, njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen, ose përfundojnë.

Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet më poshtë:

3.2.1 Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë paranë në arkë, llogari rrjedhese në bankë, investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitet original 12 muaj ose me pak dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizuar në bilancin kontabël.

3.2.2 Huatë

Huatë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interest efektiv.

3.2.3 Llogari të arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

3.2.4 Llogari te pagueshme tregtare dhe te tjera

Pas njohjes fillestare llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera njihen me koston e amortizuar.

3.3 Aktive afatgjata material

3.3.1 Njohja dhe matja

Aktive afatgjata materiale paraqiten me koston e tyre të blerjes minus amortizimin e mbartur dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kostot përfshijne edhe shpenzimet që lidhen direkt me blerjen e aktivitetit. Kur pjesë të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si pjesë të veçanta (pjesët e mëdha) të aktiveve afatgjata.

3.3.2 Kostot e mëvonshme

Në vlerën e mbartur të një njësie të aktiveve afatgjata materiale Shoqëria njih kostot e zëvendësimit të një pjese të kësaj njësie kur ka ndodhur kjo kosto, në qoftese është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me këtë njësi do të shkojnë Shoqërisë dhe kostoja e njësisë të mund të matet me besueshmëri. Te gjitha kostot e tjera njihen në pasqyrën e performancës si një shpenzim në momentin që ndodh.

3.3.3 Amortizimi

Amortizimi i vendosur në pasqyrën e performancës është llogaritur sipas metodës së amortizimit zbritës të llogaritur mbi vlerën e mbetur të aktivitetit. Normat e amortizimit për periudhen aktuale dhe të mëparshme janë si më poshtë:

Pajisje Informatike	20-25%
Automjete	20%
Mobilje zyre	20%
Godina	0.5%
Të tjera	20%

Llogaritja e amortizimit për AQT e hyra gjatë viti bëhet duke filluar nga data një e muajit pasardhës.

3.4 Aktive afatgjata jomateriale

3.4.1 Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata jo material paraqiten me koston e tyre të blerjes minus amortizimin e mbartur dhe humbjet nga rënia në vlerë.

3.4.2 Kostot e mëvonshme

Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm në qoftëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me këtë njësi do të rriten. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë emrin e mirë të gjeneruar nga brenda për markën, njihen në pasqyrën e performancës në momentin që ndodhin.

3.4.3 Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktivit, minus vlerën e mbetur.

Amortizimi i njohur në pasqyrën e performancës është llogaritur sipas metodës së amortizimit zbritës për programet kompjuterike me një normë amortizimi vjetor 25%.

3.5 Provigjonet

Një provigjon njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv, që mund të matet në mënyrë të besueshme, si rezultat i një ngjarje të shkuar dhe është e mundur që një fluks dalësh përfitimesh ekonomike të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provigjonet përcaktohen duke aktualizuar flukset e ardhshme të pritshme të parasë në një normë para tatimit e cila pasqyron vlerësimin aktual të tregut dhe rreziqet e lidhura me detyrimin.

3.6 Humbjet nga zhvlerësimi

3.6.1 Aktivët Financiare

Një aktiv financiar konsiderohet të jetë i zhvlerësuar nëse evidencat objektive tregojnë në një ose më shumë ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e ardhshme të vlerësuara të atij aktivi.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë midis vlerës neto kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara skontuar me normën fillestare të intesitetit efektiv.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

3.6.2 Aktivët jo-Financiare

Vlera neto kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë të ndryshme nga inventari rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë të aktivitetit. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, vlera e rikuperueshme e aktivitetit vlerësohet.

Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e performancës.

3.7 Njohja e të ardhurave

3.7.1 Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve

Të ardhurat nga shërbimet regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pamvarsisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës. Të ardhurat nga interes regjistrohen në momentin e maturimit të tyre.

Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjestim me periudhën arsimore të çdo Viti Akademik. Viti akademik shtrihet në periudhën nga shtatori deri në qershor të vitit fiskal pasues.

Të ardhurat e përlogaritura për periudhën akademike janar –qershor 2019, të Vitit Akademik 2018-2019 i njihen në vitin 2019. Të ardhurat e përlogaritura për periudhën shtator-dhjetor 2019 të vitit të vitit akademik 2019 -2020 njihen në vitin 2019.

3.8 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria në rrjedhen normale të biznesit të saj paguan kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore në emër të vetë dhe punonjësve të saj sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi. Kostot e kryera në emër të Shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës.

3.9 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e performancës. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e performancës me metodën e interesit efektiv.

3.10 Pagesat e qirasë

Pagesat e qirasë operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë të përfutur njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshijnë tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në pasqyrën e performancës përveçse në rastin kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në Kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohëshme midis vlerave kontabël (neto) të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë aktiv njihet nëse është e mundur që fitime të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohëshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen derisa të mos jetë më e mundur të realizohen përfitime tatimore të lidhura me to.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit të periudhës dhe tatimit të shtyrë, Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse do të ngarkohen detyrime tatimore apo interesa shtesë. Shoqëria beson së përlogaritjet e bëra për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura, bazuar në vlerësimin e shumë faktoreve, duke përfshirë interpretimet e legjislacionit tatimor për përvojat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në parashikime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh në ngjarjet e ardhshme.

Informacione të reja që mund të bëhen të disponueshme, mund të ndikojnë në ndryshimin e vendimit të Shoqërisë në lidhje me përshtatshmerinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

Shkalla tatimore për tatimin mbi fitimin për vitin ushtrimor është 15%.

3.12 Fondi i pensioneve

Shoqëria paguan kontributet për pensione si edhe kontributet për sigurime shëndetësore për punonjësit e saj siç parashikohet në legjislacionin social në Shqipëri. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe shpenzimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe shpenzime shëndetësore.

4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të kërkon që drejtimi të bëjë vlerësime, gjykime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe supozimet bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë të ndryshëm që në varësi të rrethanave besohet të jenë të arsyeshëm, rezultatet e së cilës formojnë bazën për të bërë gjykime rreth vlerave të mbartura të aktiviteteve dhe detyrimeve që nuk janë lehtësisht të identifikueshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur vlerësimi është rishikuar në rastin kur rishikimi ka ndikim vetëm në atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme në rastin kur rishikimi ndikon të dyja periudhat, si periudhën aktuale dhe atë të ardhshme.

Provizionimi i llogarive të arkëtueshme

Shoqëria rishikon llogaritë e arkëtueshme në mënyrë që të vlerësojë humbjen nga rënia në vlerë në baza vjetore. Për të përcaktuar nëse një humbje nga rënia në vlerë duhet njohur, Shoqëria gjykon nëse ka të dhëna të dukshme që tregojnë nëse ka një rënie të matshme në fluksin e ardhshme të parasë. Shoqëria përdor një model të thjeshtuar zhvlerësimi të llogarive të arkëtueshme duke konsideruar informacionin specifik. Shoqëria kryen vlerësimin për zhvlerësim duke marrë parasysh gjendjen financiare të debitorëve dhe aftësinë e tyre për përmbushjen e kushteve të kredisë së bashku me kushtet e tjera specifike të kontratave.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kosto në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmërinë e pritur të këtyre aktiveve. Megjithatë, rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.

Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me parimin e vjueshmërisë, i cili nënkupton se Shoqëria do të vazhdojë operacionet e saj në një periudhë kohe të papërcaktuar, në të ardhmen e parashikuar.

Në 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit deklaroi gjendjen e COVID-19 si një pandemi në nivel global. Duke iu përgjigjur kërcënimit potencialisht serioz që COVID - 19 paraqet për shëndetin publik, në 12 Mars 2020 autoritetet qeveritare të Shqipërisë kanë ndërmarrë masa për kontrollimin e përhapjes, duke përfshirë futjen e kufizimeve në lëvizjen ndërkuftare të njerëzve, kufizimet e hyrjes për vizitorët e huaj në pritje të zhvillimeve të mëtejshme.

4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Në veçanti, shkollat, universitetet, restorantet, kinematë, teatrot, muzetë dhe objektet sportive, shitësit me pakicë, duke përfshirë shitësit e ushqimit, dyqanet ushqimore dhe farmacitë ishin të mbyllura. Disa biznese në Shqipëri gjithashtu kanë udhëzuar punonjësit të qëndrojnë në shtëpi dhe kanë zvogëluar ose pezulluar përkohësisht operacionet e biznesit.

Shpërthimi i pandemisë së Covid-19 pati ndikime të madh në lidhje me situatën e likuiditetit të Shoqërisë gjatë muajve të parë të vitit 2020.

Arkëtimet e vitit akademik Shtator 2019- Qershor 2020 u kryen gjatë muajit Janar 2020, dhe vetëm 16% e studenteve që paguajnë me këste mujore, ndërprejnë arkëtimet e tyre gjatë muajve Mars-Maj 2020 dhe rifilluan pagesat gjatë muajit Qershor 2020.

Periodha mars –prill në situata normale është periudhë arkëtimesh dhe rezervimesh për vitin e ardhshëm akademik 2020-2021 për studentet ekzistues.

Gjithashtu nga ana e Shoqërisë Montessori-Albania Shpk nuk pati kompesime të kuotës arsimore pasi mësimdhënia u zhvillua normalisht përveç shërbimit të transportit për studentet e Institucionit WAT të cilë do të kompensohen për periudhën Mars-Qershor 2020. Nxënësve të institucionit IMSA që janë grupmosha 1-5 vjeç mësimi dhe transporti i munguar gjatë periudhës së masave të qeverisë u zëvendësuan në periudhën qershor - gusht 2020.

Shoqëria menaxhoi situatën me furnitorët duke ndërprerë shërbimet mujore për uljen e kostove siç ishin mirëmbajtja e godinave, shërbimi katering dhe transporti.

Gjithashtu gjatë kësaj kohe u rishikuan kushtet e kontratës me furnitorët për menaxhimin sa më të mirë të shërbimit duke u përshtatur situatës aktuale.

Qeveria Shqiptare nuk miratoi masa specifike lehtësuese për biznesin e arsimit. Masat lehtësuese ekonomiko-financiare të miratuara nga qeveria (si qiratë, shtyrja e afatit të pagesës së tatimit, etj) ishin të zbatueshme vetëm për bizneset e vogla (me xhiro vjetore deri 14 milionë lekë).

Montessori Albania nuk përfitoi nga të tilla lehtësira, përveç mundësisë të njoftuar nga qeveria dhe Banka e Shqipërisë për marrje kredi të garantuar nga garancia sovrane lëshuar nga qeveria për financimin e bizneseve për pagat e punonjësve.

Shoqëria gjithashtu aplikoi për shtyrjen e kësteve të kredisë gjatë periudhës së masave të qeverisë për karantinimin e bizneseve si edhe ristruktori huanë ekzistuese me FIBANK.

Shpërthimi i epidemisë zhvendosi në kohë arkëtimet e parashikuara në këtë periudhë.

Për vitin akademik 2020 2021 Shoqëria parashikon një ulje të të ardhurave dhe arkëtimeve nga 10 % deri në 20%.

Shoqëria është duke rishikuar buxhetin për 2020 për periudhën e mbetur të vitit, meqenëse parashikimet e bëra në fillim të vitit nuk janë arritur.

Shoqëria është në procesin e vlerësimit dhe marrjes së masave për parandalimin e ndikimeve negative në aktivitetet e saj dhe vlerëson se do të vijojë aktivitetin bazuar mbi parimin e vijmësisë, për një periudhë kohe të paktën për 12 muajt e ardhshëm.

5. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj përbëhen nga mjetet monetare në bankë dhe në arkë të paraqitura si në vijim:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Vlera monetare në bankë	6,442,991	11,043,069
Totali	6,442,991	11,043,069

6. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme tregtare paraqiten si më poshtë :

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme nga studentët	90,318,958	87,534,703
Totali	90,318,958	87,534,703

7. Parapagim dhe shpenzime të shtyra

Ky zë përbëhet nga parapagimi për furnitorët dhe shpenzimet e periudhave të ardhshme e detajuar si më poshtë :

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Parapagime për furnitorët	5,475,495	2,219,630
Parapagime për tatim fitimin	1,749,936	5,024,078
Shpenzime të periudhave të ardhshme	5,442,866	6,168,826
Te tjera llogari të arkëtueshme	3,463,735	3,463,735
Totali	16,132,032	16,876,269

Parapagime për furnitorët në vlerën prej 5,475,495 Lekë (2018 2,219,630) përfaqëson kërkesat për furnizim nga të tretët.

Shpenzime të periudhave të ardhshme përfaqësojnë kosto të licensave dhe platformave arsimore online të Grupit IB, për vitin akademik 2019-2020.

8. Aktive Afatgjata Materiale

Lëvizjet e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM) janë pasqyruar në tabelën si në vijim: Në fund të vitit shoqëria ka hartuar inventarin e aktiveve afatgjata materiale ku ato paraqiten më vlerën e tyre historike.

Kosto	Toka	Ndertesat	Mobilje e Orendi	Mjete Transporti	Pajisje kompjuterike	Pajisje elektronike	Të tjera	Totali
Gjendje më 1 janar 2018	67,030,072	313,074,759	25,138,058	23,363,880	13,544,082	6,779,192	11,391,561	460,321,604
Shtesa	-	2,615,964	1,489,845	12,627	756,761	16,000	2,382,626	7,273,823
Gjendje më 31 dhjetor 2018	67,030,072	315,690,723	26,627,903	23,376,507	14,300,843	6,795,192	13,774,187	467,595,427
Pakesime	-	-	-	(510,629)	-	-	(232,250)	(742,879)
Shtesa	-	-	122,256	2,986,305	789,149	8,980	25,217	3,931,907
Gjendje më 31 dhjetor 2019	67,030,072	315,690,723	26,750,159	25,852,183	15,089,992	6,804,172	13,567,154	470,784,455
Zhvlerësimi i akumuluar								
Gjendje më 1 janar 2018	-	(9,456,081)	(11,109,723)	(7,927,919)	(6,077,185)	(3,292,233)	(3,476,014)	(41,339,185)
Amortizimi i vitit 2018	-	(1,809,537)	(2,944,889)	(3,088,665)	(1,960,429)	(700,059)	(1,206,664)	(11,810,283)
Gjendje më 31 dhjetor 2018	-	(11,365,618)	(14,054,612)	(11,016,584)	(8,037,614)	(3,992,292)	(4,682,678)	(53,149,428)
Amortizimi i vitit 2019	-	(1,887,237)	(2,524,848)	(2,655,854)	(1,671,726)	(562,226)	(1,283,061)	(10,584,950)
Gjendje më 31 dhjetor 2019	-	(13,252,855)	(16,579,458)	(13,672,438)	(9,709,350)	(4,554,518)	(5,965,739)	(63,734,378)
Vlera neto kontabël								
Gjendje më 1 janar 2018	67,030,072	303,618,678	14,028,335	15,435,961	7,466,887	3,486,959	7,915,547	418,982,439
Gjendje më 31 dhjetor 2018	67,030,072	304,325,105	12,573,291	12,359,923	6,263,219	2,802,900	9,091,489	414,445,999
Gjendje më 31 dhjetor 2019	67,030,072	302,437,868	10,170,701	12,179,745	5,380,642	2,249,654	7,601,395	407,050,077

Shoqëria ka të vendosura si kolateral për kredinë ndaj FIB Bank një Apartament, Tokë Arë Mjull Bathore, Tokë truall dhe godinën e shkollës W.A.T.

Mirindete Bodurjaku



9. Aktiveve Afatgjata Jomateriale

Kosto	Programe Software	Totali
Gjendje më 1 janar 2018	2,419,859	2,419,859
Shtesa	1,215,576	1,215,576
Gjendje më 31 dhjetor 2018	3,635,435	3,635,435
Shtesa	-	-
Gjendje më 31 dhjetor 2019	3,635,435	3,635,435
Zhvierësimiil akumuluar		
Gjendje më 1 janar 2018	(349,066)	(349,066)
Amortizimi i vitit 2018	(687,492)	(687,492)
Gjendje më 31 dhjetor 2018	(1,036,558)	(1,036,558)
Amortizimi i vitit 2019	(649,719)	(649,719)
Gjendje më 31 dhjetor 2019	(1,686,277)	(1,686,277)
Vlera neto kontabël		
Gjendje më 1 janar 2018	2,070,793	2,070,793
Gjendje më 31 dhjetor 2018	2,598,877	2,598,877
Gjendje më 31 dhjetor 2019	1,949,158	1,949,158

10. Hua nga bankat

Në këtë zë janë paraqitur huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Huamarrje afatshkurtër:		
Hua afatshkurtër BKT Bank	28,700,000	35,000,000
Hua afatshkurtër FIB Bank	54,875,132	41,403,193
Total hua afatshkurtër	83,575,132	76,403,193
Huamarrje afatgjatë:		
Huamarrje afatgjatë Fib Bank	129,895,495	150,476,984
Total hua afatgjatë	129,895,495	150,476,984
Totali	213,470,627	226,880,177

Overdrafti përfaqëson një financim me afat një vjeçar në bazë të një marrëveshje të lidhur në 02.11.2017 Shuma e kredisë do të jetë 28,700,000 Leke, e cila do të përdoret për kapital punues në formën e një Linje Qarkulluese Kreditimi. Norma e interesit e aplikuar mbi kredinë është Bono Thesari 1-vjeçare +3.5 (tre pikë pesë)% por jo më pak se 8% (tetë) mbi shumën 28,700,000 Lekë me bazë vjetore e ndryshueshme në çdo disbursim.

10. Hua nga bankat (vazhdim)

Huamarrja afatgjatë përfaqëson një financim me afat 4 (katër) vjeçar në bazë të një marrëveshje të lidhur me FIB Bank në 12 mars 2015 në vlerën prej 2.000.000 Euro e cila është ristrukturuar në 21 nëntor 2016. Norma e interes të aplikuar mbi kredinë në bazë të Euribor 12 mujor -0.073% por jo më pak se 7.5 (Shtatë pikë pesë) % për një periudhë 4(katër) vjeçare. Në datë 30 nëntor 2018, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë vendosi miratimin e shtesës së huasë në vlerën 80,000 Euro dhe kolateralit financiar në vlerën 45,000 Euro për garantimin e detyrimeve të huasë. Në datë 4 dhjetor 2018, Shoqëria ka nënshkruar amendimin e kontratës së huasë me bankën. Kolaterali i vendosur për këto kredi përbëhet nga një Apartament, Tokë arë Mjull Bathore, Tokë truall dhe godinën e shkollës W.A.T.

11 Qira financiare

Shoqëria ka hyrë në katër kontrata të qirasë financiare për katër makina të cilat përdoren për transportin e nxënësve. Një prej tyre daton që vitin 2013 dhe dy kontrata të reja me kohëzgjatje 60 muaj janë nënshkruar në vitin 2016 për dy mjete transporti.

Në korrik të vitit 2019, Shoqëria nënshkroi një kontratë të re të qirasë financiare.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Qira financiare afatshkurtër	2,611,303	1,985,306
Qira financiare afatgjatë	5,062,403	5,482,015
Totali	7,673,706	7,467,321

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të pagueshme tregtare	103,537,259	88,179,282
Totali	103,537,259	88,179,282

13. Detyrime Tatimore

Detyrimet Tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	2,778,112	2,727,332
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	2,565,205	3,158,457
Tatimi në burim	165,173	171,785
Totali	5,508,490	6,057,574

14. Të ardhura të shtyra

Të ardhura të shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura të shtyra	199,777,294	209,680,361
Totali	199,777,294	209,680,361

Të ardhurat e shtyra përfshijnë të ardhurat nga kuotat arsimore për vitin akademik 2019-2020.

15. Të tjera detyrime

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paga për tu paguar	8,625,100	10,245,067
Kreditore të tjerë	3,149,344	-
Totali	11,774,444	10,245,067

16. Të tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	45,059,512	46,350,772
Totali	45,059,512	46,350,772

Detyrimet ndaj palëve të lidhura janë shlyer në muajin maj 2020. Në muajin prill 2020 bazuar në vendimin e Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve, Shoqëria ka miratuar një kontratë kredie Bankare nga Banka Kombëtare Tregate (BKT) në shumën 350.000 EUR, e cila do të shërbejë për kthimin e huasë që Shoqëria i detyrohet dy ortakëve të saj.

17. Grante dhe të ardhurat e shtyra

Grante dhe të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Grantet dhe të ardhura të shtyra afatgjatë	5,178,039	5,178,039
Totali	5,178,039	5,178,039

18. Kapitali aksionar

Kapitali i nënshkruar është 100.000 Lekë dhe struktura e pronësisë së Institucionit Montessori- Albania Shpk është i përbërë nga dy ortakë të cilët respektivisht janë të ndarë në kuota dhe në vlerë si më poshtë:

Ortakët e Shoqërisë	Në %	Në Lekë
Luanesha Çelmeta	60	60,000
Semiha Molla	40	40,000
Totali	100	100,000

19. Tepricë nga rivlerësimi

Teprica nga rivlerësimi përfaqëson rezerva nga rivlerësimi i AAM në Shumën 2,252,077 lekë . Kjo shumë është zvogëluar në krahasim me vitin 2018 në shumën 511,789 lekë e cila përfaqëson diferencën midis amortizimit nga rivlerësimi me amortizimin me koston historike të AAM për vitin 2019.

20. Fitime të pashperndara

Fitimet e pashpërndara paraqiten në vlerën (69,379,965) leke e cila është pakesuar me të njëjtën vlerë me pakësimin e zërit Teprica nga rivlerësimi.

21. Rezultati i ushtrimit

Shuma prej 2,546,486 lekë përfaqëson humbjen neto të vitit ushtrimor 2019 (2018: (36,319,369) lekë)

22. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat lidhen me kryerjen e shërbimeve mësimdhënie në nivelet parashkollor, 9-vjeçar dhe të mesëm, kurse të ndryshme dhe transport.

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit përfshijnë të ardhurat nga kuotat arsimore për vitin fiskal 2018 i cili përfshin dy vite akademike 2018-2019 dhe 2019-2020. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga kuota arsimore	349,635,210	350,268,936
Të ardhura nga transporti	10,251,581	8,220,602
Të ardhura të ndryshme	4,023,062	3,786,213
Të ardhura nga maturat	3,414,074	-
Totali	367,323,927	362,275,751

23. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat të tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktivitetit tregtar dhe të ardhurat e tjera të cilat detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga kompet verore	1,398,148	1,903,147
Të ardhura të tjera financiare	1,014,614	1,297,558
Të ardhura nga granti	-	519,083
Të ardhura nga shitja e aktiveve	756,893	-
Të ardhura nga dhuratat dhe ndihmat	452,799	-
Të ardhura nga demshperblimet	90,000	-
Totali	3,712,454	3,719,788

24. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime energjie elektrike	3,812,585	4,507,046
Shpenzime uje te pijshem	1,611,139	1,337,390
Shpenzime gaz dhe karburant	2,953,786	4,017,008
Totali	8,377,510	9,861,444

25. Të tjera shpenzime administrative

Shpenzime të tjera përfshijnë shërbimet dhe materialet e konsumuara të cilat detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime konsulence trajnime dhe perkthimi	7,485,542	10,743,779
Furnitura	1,313,313	405,620
Qera ambjentesh	13,042,105	13,550,093
Mirëmbajtje dhe riparime	12,088,312	14,299,202
Telefon/internet /posta	2,079,706	1,602,554
Shërbim roje, pastrimi	4,028,640	3,167,052
Shërbim transporti	4,119,320	4,263,795
Siguracione	1,091,646	837,136
Komisione bankare	911,062	3,423,631
Taksa dhe tarifa vendore	1,773,921	3,380,645
Shpenzime pritje dhe përcjellje	548,996	657,228
Shpenzime katering	51,190,952	50,674,983
Të tjera	3,350,599	6,117,629
Totali	103,024,112	113,123,347

26. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime Paga dhe shperblime	202,793,799	205,445,269
Shpenzime Sigurime Shoqerore dhe Shendetësore	18,852,648	17,448,158
Total	221,646,447	222,893,427

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëriaka të punësuar një total prej 96 punonjës dhe drejtues përfshirë edhe Administratorin, krahasimisht (2018: 106 punonjës).

27. Shpenzime amortizimi

Shpenzimet e amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime amortizimi	11,234,669	12,497,755
Totali	11,234,669	12,497,755

28. Shpenzime të tjera shrytëzimi

Shpenzime të tjera shrytëzimi detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime Pritje Percejllje	4,472	85,314
Shpenzime te panjohura kuota arsimore	6,297,403	10,478,737
Shpenzime te panjohura per stafin e huaj	2,824,264	6,126,697
Dëmshperblime per vendimin nga gjykata	-	2,854,205
Subvencione te dhena	232,250	-
Totali	9,358,389	19,544,953

29. Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për periudhën 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	14,939,499	19,400,417
Shpenzime/(të ardhura) të tjera financiare	1,164,549	4,625,348
Totali	16,104,048	24,025,765

30. Shpenzimi i tatim fitimit

Përlogaritja e shpenzimit për tatim fitimi paraqitet me poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi/(humbja) para tatimit	1,291,208	(35,951,152)
Shpenzime të panjohura	24,293,416	38,405,932,
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	26,096,412	2,454,780
Fitim (humbje) fiskale	26,096,412	2,454,780
Tatim fitimi 15%	3,837,693	368,217
Humbje neto	(2,546,486)	(36,319,369)

31. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari te pagueshme nga palët e lidhura	45,059,512	46,350,772
Grante dhe të ardhurat e shtyra	5,178,039	5,178,039
Totali	50,237,551	51,528,811

Monedhat e huaja me të cilat Shoqëria kryesisht vepron janë: Euro, USD dhe GBP. Kurset e këmbimit të përdorura për konvertim më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

Monedha	2019	2018
1 EUR	121.77	123.42
1 USD	108.64	107.82
1 GBP	143	137.42

32. Ngjarje pas datës bilancit

Gjatë fillimit të vitit 2020, globalisht u përhap pandemia e COVID -19. Në Shqipëri, impaktin masiv e pati prej muajit mars 2020, kur qeveria morri masa drastike duke pezulluar gjithë aktivitetet te cilat nuk ishin jetike. Shoqëria është në procesin e vlerësimit dhe marrjes së masave për parandalimin e ndikimeve negative në aktivitetet e saj. Shoqëria ka përcaktuar që këto ngjarje nuk janë rregulluese të ngjarjeve pasuese. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e operacioneve që nga dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 nuk janë rregulluar për të pasqyruar ndikimin e tyre.

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime apo shpjegime shtesë në këto pasqyra financiare.